

S H E N I M E T S H P J E G U E S E

Sqarim:

Dhënia e shënimeve shpjeguese në këtë pjesë është sipas SKK 2.
 Plotesimi i te dhenave të kësaj pjese është bere sipas kërkesave dhe strukturës standarte te percaktuara ne SKK 2 dhe konkretisht paragrafeve 86-94. Rradha e dhenies se spjegimeve eshte :

- a) Deklorojme qe pasqyrat financiare jane pergatitur ne perputhje me Standartet Kombetare te Kontabilitetit
- b) Politikat kontabel me te rendesishme te zbatuara
- c) **Informacion mbeshtetes per zerat e paraqitur ne pasqyrat financiare**
- f) Shënime të tjera shpjeguese

A I Informacion i përgjithshëm

- 1 Kuadri ligjor: Ligjit 9228 dt 29.04.2004 "Per Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare", **UMF nr.64 date 22/07/2014, Per shpalljen e SKK-ve te permiresuara.**
- 2 Kuadri kontabel i aplikuar : Stndartet Kombetare te Kontabilitetit ne Shqiperi.(SKK 2; 86)
- 3 Baza e pergatitjes se PF : Te drejtat dhe detyrimet e konstatuara.(SSK 1, 41)
- 4 Parimet dhe karakteristikat cilesore te perdorura per hartimin e P.F. : (SKK 1; 66 - 90)
 - a) NJESIA EKONOMIKE RAPORTUSE ka mbajtur ne llogarite e saj aktivet,pasivet dhe transakcionet ekonomike te veta.
 - b) VIJIMESIA e veprimtarise ekonomike te njesise sone raportuse eshte e siguruar duke mos pasur ne plan ose nevojte nderprerjen e aktivitetit te saj.
 - c) KOMPENSIM midis nje aktivi dhe nje pasivi nuk ka , ndersa midis te ardhurave dhe shpenzimeve ka vetem ne rastet qe lejohen nga SKK.
 - d) KUPTUSHMERIA e Pasqyrave Financiare eshte realizuar ne masen e plote per te gene te qarta dhe te kuptushme per perdorues te jashtem qe kane njohuri te pergjitheshme te mjaftueshme ne fushen e kontabilitetit.
 - e) MATERIALITETI eshte vleresuar nga ana jone dhe ne baze te tij Pasqyrat Financiare jane hartuar vetem per zera materiale.
 - f) BESUSHMERIA per hartimin e Pasqyrave Financiare eshte e siguruar pasi nuk ka gabime materiale duke zbatuar parimet e meposhteme :
 - Parimin e paraqitjes me besnikeri
 - Parimin e perparesise se permbajtjes ekonomike mbi formen ligjore
 - Parimin e paaneshmerise pa asnje influencim te qellimshem
 - Parimin e maturise pa optimizem te teperuar,pa nen e mbivleresim te qellimshem
 - Parimin e plotesise duke paraqitur nje pamje te vertete e te drejte te PF.
 - Parimin e qendrushmerise per te mos ndryshuar politikat e metodat kontabel
 - Parimin e krahasushmerise duke siguruar krahasimin midis dy periudhave.

A II Politikat kontabël

Per percaktimin e kosos se inventareve eshte zgjedhur metoda "Mesatares se Ponderuar " (SKK 4: 14)

Vleresimi fillestar i nje elementi te AAM qe ploteson kriteret per njohje si aktiv ne bilanc eshte vleresuar me kosto. (SKK 5; 11)

Per prodhimin ose krijimin e AAM kur kjo financohet nga nje hua,kostot e huamarrjes (dhe interesat) njihen si shpenzime ne periudhen ne te cilen ato ndodhin .(SKK 5: 14)

Per vleresimi i mepasshem i AAM eshte zgjedhur modeli i kosos duke i paraqitur ne bilanc me kosto minus amortizimin e akumuluar. (SKK 5; 18)

Per llogaritjen e amortizimit te AAM (SKK 5: 32) njesia jone ekonomike ka percaktuar si metode te amortizimit te AAM metoden e amortizimit mbi bazen e vlefes se mbetur ndersa normat e amortizimit jane perdorur te njellojta me ato te sistemit fiskal ne fuqi dhe konkretisht :

- Per ndertesat me 5 % te vleres se mbetur.
- Kompjutera e sisteme informacioni me 25 % te vlefes se mbetur
- Te gjitha AAM te tjera me 20 % te vlefes se mbetur

Per llogaritjen e amortizimit te AAJM (SKK 5: 69) njesia ekonomike raportuese ka percaktuar si metode te amortizimit metoden lineare ndersa normen e amortizimit me 15 % ne vit.